



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.14/24

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.Sh, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga M.G, nga fshati Q..., K.. e P..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 20.12.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga M.G nga fsh. Q..., K.. e P..., ndaj gjyqtarit B.Sh, **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 25.11.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga M.G nga fsh. Q..., K.. e P..., ndaj gjyqtarit B.Sh, me arsyetimin se i njëjti ka qenë gjyqtar i çështjes në lëndën C.nr.2404/23, ku paditës ka qenë parashtruesi dhe vëllai i tij A.G, të përfaqësuar nga av.N.H dhe av.B.A dhe ka kërkuar që të vërtetohet se janë pronar të parcelës nr.448/10 ZK-Pejë ndaj të paditurve Sh, A dhe R. L nga fsh.I..., K... e D..., ku nga ai fshat ishte edhe gjyqtari B.Sh, po ashtu edhe avokati i të paditurve O.. Thekson se ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit dhe kryetari ka refuzuar kërkesën. Në deklaratimet e tij është shprehur se para se të përfundonte seanca, av.B.A ka kërkuar prej gjyqtarit 10000 euro, në prezencë të djalit të vëllait A.G, thekson se nuk e kanë dhënë këtë shumë dhe humben kontesti, lënda është në ankesë në apel. Ka theksuar se këtë rast e ka lajmëruar A. G tek kryetari me datën 01.11.2024 dhe avokatin e ka paraqitur në prokurori me datë 01.11.2024. Kërkon që të ndërmerren masa disiplinore kundër gjyqtarit, sepse i ka humbur kontestin duke mos nxjerr provat siç ka thënë gjykata e Apelit, dhe ka shkaktuar dëm të madh material. Përfundimisht ka deklaruar se gjyqtari dhe avokati kanë bashkëpunuar në këtë kontest vetëm për të marrë shumën prej 10000 euro.

Me datë 25.11.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga M.G, ndaj gjyqtarit B.Sh.

Gjyqtari B.Sh, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se e kundërshton në tërësi si të pavërtete dhe të trilluar. Ka njoftuar se lidhur me rastin ku i është keqpërdorur emri i tij në lëndën C.nr.2404/23, ku paditës ka qenë M.G nga fsh. Q..., K.. e P..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av.N.H dhe av. B.A dhe paditësi A.G, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av.N.H, kundër të paditurve Sh, A dhe R. L nga fsh.I..., K... e D..., të përfaqësuar sipas autorizimit nga av.I.O, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë sipas kontratës gojore, e njëjta lëndë ka përfunduar me aktgjykimin e datës 24.05.2024. Ka theksuar se për këtë çështje ka njoftuar Prokurorinë Themelore në Pejë, me parashtrësën e datës 05.11.2024, pasi që të njëjtat pretendime janë ngritur edhe nga djali i axhës së ankuesit A.G. Thekson se lidhur me pretendimet e parashtruesit në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore për një rast ku i njëjti nuk ka qenë në dijeni deklaron se këto akuzë nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që një avokat ka lakuar emrin e gjyqtarit e për këtë çështje është njoftuar Prokuroria Themelore në Pejë. Tutje, në deklaratën e tij thekson se sa i përket pretendimit se i njëjti është nga fshati I..., K...e D... dhe palët e paditura dhe i autorizuari i tyre janë nga i njëjti fshat, ky fakt është kontestuar edhe në deklaratën për përjashtim, mirëpo ka ritheksuar faktin se i njëjti ka lindur në Komunën e Pejës gjithashtu edhe prindi i tij, pra nuk kam asnjë lidhje gjaku apo ndonjërin nga rrethanat që parashihen me dispozitat e LPK-së si bazë për përjashtim. Ka deklaruar se në analizën e theksimeve të parashtruesit është shumë e qartë se shumica e akuzave janë orientuar drejtë avokatit, ndërkohë emri i gjyqtarit është përmendur në një kontest që lidhet me një veprim për të cilin nuk ka njohuri dhe kjo situatë ngrit shqetësime rreth saktësisë dhe qëllimit të akuzave të paraqitura, andaj e konsideron të nevojshme që organet kompetente të vërtetojnë këto pretendime. Tutje thekson se e kundërshton pretendimin e parashtruesit, ku emri i tij është keqpërdorur nga një avokat, këtë akuzë e konsideron të papranueshme, të pavërtetë dhe e dëmshme për reputacionin e tij profesional. Përfundimisht thekson se nuk ka komunikuar në asnjë rrethanë me avokatët për çështje të lëndëve asnjëherë, një veprim i tillë është i ndaluar dhe përben një shkelje të rëndë të parimeve të drejtësisë, deklarohet se pretendimet e parashtruesit janë të paqëndrueshme dhe nuk pasqyrojnë realitetin e veprimeve të tij si gjyqtar, të cilat janë gjithmonë të drejtuara drejtësisë dhe ndershmërisë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.Sh, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore që kanë të bëjnë me veprimet e gjyqtarit B.Sh, lidhur me lëndën kontestimore C.nr.2404/23, sipas padisë së paditësve M.G(paraqitësi i ankesës disiplinore) dhe A.G, që të dy nga fshati Q..., K... P..., të përfaqësuar nga avokat N.H, nga P..., kundër të paditurve Sh, A dhe R. L nga fsh.I..., K... e D..., të përfaqësuar nga avokat I.O, nga D...

Sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës se ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit nga kjo çështje civile, me arsyetimin se gjyqtari është nga fshati i njëjtë me të paditurit dhe se banorët e fshatit I..., janë të afërm me njërit tjetrin e po ashtu edhe avokati i të paditurve është nga i njëjti fshat, autoriteti kompetent konstaton se është e vërtetë se paditësit-paraqitësi i ankesës disiplinore me datë 27.11.2023, ka parashtruar kërkesë për përjashtim të gjyqtarit në këtë çështje civile, me arsyetimet si me lartë, mirëpo, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me asnjë shkelje nga ana e gjyqtarit të çështjes ngase i njëjti në po të njëjtën datë ka dhënë deklaratën lidhur me kërkesën për përjashtim dhe lëndën e ka dorëzuar te kryetari i gjykatës për vendosje. Kryetari i gjykatës me aktvendimin C.nr.2404/23, te datës 19.01.2024, e ka refuzuar kërkesën paditësit M.G, për përjashtimin e gjyqtarit B.Sh, si të pabazuar, meqenëse ka gjetur se e njëjta nuk ka mbështetje në nenin 67 të LPK-së. Andaj, pretendimi i paditësit se gjyqtari paska bërë shkelje disiplinore në këtë rast nuk qëndron, ngase gjyqtari i çështjes B.Sh, ka vepruar konform Ligjit të procedurës Kontestimore duke dhënë deklaratën lidhur me kërkesën e paditësit për përjashtim dhe lëndën e ka dërguar tek kryetari për vendosje.

Lidhur me pretendimin e paditësit se para se të përfundonte seanca, avokati B.A, ia ka kërkuar prej gjyqtarit 10,000 euro, në prezencën e djalit të vëllait të ti A.G, të njëjtit nuk ia kanë dhënë dhe e kanë humbur kontestin dhe se këtë rast e ka lajmëruar djali i vëllait te tij A, te kryetari i gjykatës Armend Berisha me datë 01.11.2024, dhe avokatin e kanë paraqitur në prokurori, autoritetit kompetent vlerëson se nuk ka kompetencë e as autoritet të ndërmerri ndonjë masë mbi veprimet e avokatëve, dhe se për këtë vendosin organet kompetente, ndërsa sa i përket gjyqtarit B.Sh, në këtë rast nuk është argumentuar me asnjë provë se veprimet e tij si gjyqtar te jenë te koordinuara me ato te avokatit. Mirëpo siç shihet në këtë kërkesë qëllimi i dikujt është që ta përfshinë emrin e gjyqtarit nëpër veprime joligjore pa dijeninë e tij, kjo konstatohet për faktin se paditësi M.G, ka deklaruar se avokati në emër të gjyqtarit ia ka kërkuar 10,000 euro, para se të përfundonte seanca e që i bie para muajit prill të vitit 2024, dhe se i njëjti ka pas mundësi dhe është dashur që të lajmëroj autoritetet kompetente menjëherë e jo të pres përfundimin e shqyrtimit, ta merr aktgjykimin, te ushtroj ankesë, e tek në muajin nëntor te paraqes ankesë disiplinore. E sa i përket pretendimit se gjyqtari ia paska humbur kontestin paditësit, autoriteti kompetent konstaton se gjyqtari në këtë çështje ka vepruar sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore, e ka zhvilluar procedurën dhe ka nxjerr një vendim-aktgjykim, e në të cilin i ka udhëzuar palët se kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, andaj Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, e pati të pamundur të vërtetojë pretendimet e tilla, e në rastin konkret pretendim i parashtruesit të ankesës duke mos qenë i argumentuar mbetet vetëm një supozim i palës ankuuese.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.14/24, me datë 20.12.2024**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.Sh*
- 3. Parashtruesit të ankesës – M.G, nga fsh.Q..., K... e P...*